



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 258/10 Prot.

Pogradec, më 26.01. 2024

VENDIM

Nr. 6 datë 25.01, 2024

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE, Z.NEKI HAMZALLARI PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasit Neki Hamzallari, për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 15.12.2023
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Neki Hamzallari, ndihmën emergjente në vlerën prej **164 674 LEK** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2024.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, si dhe Drejtorja e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

